



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	16 - 11 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6994/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1216/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1216/2023 të datës 27.09.2023 të ankueses me adresë banimi: Rruga Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.11.2023, mori këtë.

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1216/2023 e datës 27.09.2023 e parashtruara nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e cili sipas shkresave të lëndës ka qenë kandidatë në procedurën e rekrutimit Specialistë të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane, pozita e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim" të shpallur nga Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 27.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit: 6278/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1216/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komisioni i Pranimi ka vepruar gabimisht me rastin e vlerësimit të CV-jetëshkrimit të ankueses me 14.6 pikë, me arsyetimin se e njëjta ka përvojë dhe njohuri në sistemin GIS i cili do të aplikohet në pozitën për të cilën është shpallur konkursi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar me datë 28.09.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë



10.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë, si dhe me datë 20.10.2023 përmes e-mailit ka pranuar sqarime shtesë për lëndën e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.09.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 26.01.2023; Njoftimin e datës 03.03.2023; Njoftimin e datës 11.08.2023; Njoftimin e datës 16.03.2023; Njoftimin e datës 29.08.2023; CV-në e ankueses; Rekomandimin e datës 27.04.2023; Letër rekomandimin e lëshuar nga Urban Plus; Letër referencën e datës 26.01.2017; Letër referencën e datës 01.06.2015; Referencën e datës 21.05.2012; Letër rekomandimin e lëshuar nga Urban 3A; Letër rekomandimin e datës 21.03.2008; Letër referencën e datës 12.05.2008; Referencën e lëshuar nga EGJF; kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.09.2023; E-mailin e datës 20.10.2023 dërguar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Këshill; Përgjigjen me shkresë përcjellës e e datës 29.09.2023; vendimin e datës 20.04.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i datës 08.02.2023; Vendimin e datës 05.07.2023; Akt emërim i datës 21.03.2023; Akt emërim i datës 01.12.2021; Akt emërim i datës 01.01.2023; Vendimin e datës 20.02.2023 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Aplikacioni me dokumentacionin e kandidatit K.A i datës 18.02.2023; Aplikacioni me dokumentacionin e kandidatës A.SH i datës 22.02.2023; Aplikacioni me dokumentacionin e kandidatit E.M i datës 16.02.2023; Aplikacioni me dokumentacionin e ankueses i datës 123.02.2023; Formulari i renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 18.08.2023

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Prishtinës me datë 26.01.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit për pranim në procedurën e rekrutimit Specialistë të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane, pozita e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim", ndërsa sipas njoftimit të datës 03.03.2023 është konstatuar fakti se për pozitën e lartcekura ankuesja e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht ka hyrë në listën e ngushtë me qëllim të nënshtrimit edhe në fazat e tjera të rekrutimit.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve në procedurë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja i është nënshtruar testit me shkrim dhe ka arrit të marrë 44 pikë, ndërsa në vlerësimin e jetëshkrimit ka marrë 14.6 pikë, ashtu që ankuesja nga këto dy fazë të vlerësimit ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 58.6 pikë, e të cilat në kuptim të nenit 23 paragrafit 3 të Rregullore (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë" nuk kanë qenë pikë të mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës së fundit në procedurë të rekrutimit, gjegjësisht sipas Njoftimit të datës 11.08.2023 rezulton se ankuesja nuk është konkandidate e suksesshme, kurse njoftimi i datës 11.08.2023 ka pas edhe këshillën e dhënë juridike se palët e pakënaqura mund të parashtrorjnë ankesë Brenda tre (3) në Komisionin e Pranimit.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat e Rregullore (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 1 dhe 2 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "1. Kjo rregullore, ka për qëllim



ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe profesional për pranimin dhe avancimin në karrierë të nëpunësve civilë në pajtim me parimet themelore të Shërbimit Civil të përcaktuara në Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ( në tekstin në vijim LZP); 2.1. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë shërbimin civil në Republikën e Kosovës, ajo përcakton procedurat për pranimin, lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë (avancimin) të nëpunësit civil” dhe ka ardhur në përfundimin se kandidatët në procedurë të rekrutimit sikurse edhe institucionet që zhvillon procedurat e rekrutimit janë të obliguar të zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje për aq kohë sa e njëjta është në fuqi.

Po ashtu, Kolegji i këshillit me qëllim të shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës së ankueses ka analizuar dispozitat e nenit 31 paragrafi 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: “1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”); 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet; 4.2 kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo”, andaj në këtë kuptim Kolegji i Këshillit vlerëson se kandidatët të cilët i nënshtrohen procedurave të rekrutimit për pranim në Shërbimin Civil, kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshill, mirëpo me kushtin që paraprakisht të njëjtit t’i kenë shterur mjetet juridike për ankimim të brendshëm pranë organit që i zhvillon procedurat e brendshme, respektivisht tek Komisioni i Pranimit sikurse përcaktohet përshtatshëmrisht edhe me nenin 25 paragrafi 5 dhe 6 të së njëjtës rregullore, ndërsa duke u bazuar në pretendimet ankimore të ankueses por edhe në përgjigjen e Njësisë së Burimeve Njerëzore të Prishtinës të dhëna në shkresën e datës 10.10.2023 dhe atë të datës 20.10.2023 përmes e-mailit zyrtar, konstatohet fakti se ankuesja nuk ka parashtruar ankesë të brendshme paraprakisht sikurse përcaktohet me dispozitat e të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit nga se u tha si më lartë, njëzëri konstaton se meqenëse ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se e njëjta pavarësisht parashtrimin të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë të brendshme ankimore tek organi që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit, respektivisht tek Komisioni i Pranimit lidhur me pretendimet e saj vlerësimin e jetëshkrimit apo aktit përfundimtar të procedurës së rekrutimit, ankesa e ankueses në rrethanat e rastit konkret është e palejueshme ngase nuk është plotësuar parakushti ligjor i përcaktuar me nenit 31 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, andaj mbi bazën e analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankueses në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: “Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe” ankesa e ankueses vlerësohet të jetë e palejuar në këtë fazë të procedurës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.





**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1216/2023

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses .
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

